

VENDIM
Nr. 140, datë 22.2.2012

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 88 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shtojcën 1 “Rregullore model e planifikimit”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në nenin 1, pas fjalëve “... duke shërbyer si instrumenti i vetëm ...” shtohen fjalët “... me përjashtim të vendimeve të KRRTRSH-së, të cilat mbeten në fuqi sipas përcaktimeve në Rregulloren Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit ...”.

2. Pas nenit 5 shtohet neni 5/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Zhvillimi i infrastrukturave publike në kushtet e zbatimit të rregullores model të planifikimit

Pavarësisht nga sa përcaktohet në nenin 4 të kësaj rregulloreje, autoriteti vendor i planifikimit, subjekt i kësaj rregulloreje, jep leje zhvillimi në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, për projekte të rëndësishme të infrastrukturës publike sipas përcaktimeve të pikës 30 të nenit 3 të ligjit të sipërpërmendur, pa ndryshuar përdorimin ekzistues të tokës dhe/ose strukturave në të, të realizuara me investime, publike ose private, në zbatim të kushteve teknike të kërkuara sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha